



FEDERATA ATLETIKE E KOSOVËS

STATUTI I
FEDERATËS ATLETIKE
TË KOSOVËS

Prishtinë, Nëntor 2022

PËRMBAJTJA

Neni 1.....	4
I - DISPOZITAT THEMELORE	4
Neni 2.....	4
Neni 3.....	4
Neni 4.....	4
Neni 5.....	4
Neni 6.....	4
Neni 7.....	5
Neni 8.....	5
Neni 9.....	5
Neni 10.....	5
Neni 11.....	5
Neni 12.....	5
Neni 13.....	5
II - QËLLIMET DHE AKTIVITETI	6
Neni 14.....	6
Neni 15.....	6
Neni 16.....	7
Neni 17.....	7
Neni 18.....	7
III - ANËTARËSIA	7
Neni 19.....	7
Neni 20.....	7
Neni 21.....	8
Neni 22.....	8
Neni 23.....	8
Neni 24.....	8
Neni 25 - Përfundimi i anëtarësisë.....	8
Neni 26.....	9
IV - ORGANIZIMI.....	9
Kuvendi	9
Neni 28.....	9
Neni 29.....	10
Neni 30.....	10
Neni 31.....	10
Neni 32.....	10
Neni 33.....	11
Bordi Ekzekutiv.....	11
Neni 34.....	11
Neni 35.....	11
Neni 36.....	12
Neni 37.....	12
Neni 38.....	12
Neni 39.....	12
Këshilli Mbikëqyrës	13
Neni 40.....	13
Neni 41.....	13
Neni 42.....	13
Neni 43.....	13

Kryetari dhe nënkryetarët	13
Neni 45	14
Neni 46	14
Neni 47	14
V - ZYRA E FEDERATËS	14
Neni 48	14
Sekretari i përgjithshëm	14
Neni 50	14
Neni 51	15
VI - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE KONFLIKTET E INTERESAVE	15
Neni 52 - Komisioni Disiplinor	15
Neni 53 - Komisioni për Ankesa	16
VII – LEGJISLACIONI	16
Neni 54 - Komisioni Statutor	16
VIII - PËRFAQËSIMI SHITETËROR	16
Neni 55	16
Neni 56	16
IX - KRYERJA E PUNËVE PROFESIONALE NË ATLETIKË	16
Neni 57	16
X - ORGANIZIMI I GARAVE NDËRKOMBËTARE NË ATLETIKE	16
Neni 58	16
XI - BIZNESI MATERIAL DHE FINANCIAR	17
Neni 59	17
Neni 60	17
Neni 61	17
Neni 62	17
Neni 63	17
Neni 64	17
XII - MIRËNJOHJET DHE ÇMIMET	17
Neni 65	17
Neni 66	17
XIII - SHUARJA E FEDERATËS	17
Neni 67	17
Neni 68	17
Neni 69	18
XIV - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	18
Neni 70	18
Neni 71	18
Neni 72	18
Neni 73	18
Neni 74	18
Neni 75	18
Neni 76	18

Në bazë të ligjit Nr. 06/L-043 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare të Kosovës, Në përputhje me nenin 27 të Ligjit Nr. 2003/24 të Sportit të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-075 dhe Ligjin Nr. 06/L-115, në harmoni me statutin e Federatës Botërore të Atletikës dhe Statutin e Komitetit Olimpik të Kosovës në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit të Federatës Atletike të Kosovë, më 30.11.2022 aprovoi:

STATUTIN E FEDERATËS ATLETIKE TË KOSOVËS

Neni 1

Ky Statut rregullon dispozitat për emrin, selinë, përfaqësimin, pamja e vulës, për qëllimet dhe fushat e veprimit në përputhje me qëllimet, aktivitetet e përdorura për arritjen e qëllimeve, për mënyrën e sigurimit të publicitetit të aktiviteteve të Federatës, për kushtet dhe mënyrën e anëtarësimit dhe përfundimit të anëtarësimit, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë disiplinore të anëtarëve dhe mënyrën e mbajtjes së listës së anëtarëve, organeve të Federatës, përbërjen e tyre dhe mënyrën e thirrjes së seancave, zgjedhjen, rikthimin, kompetencat, mënyra e vendimmarrjes dhe kohëzgjatja e mandatit dhe mënyra e thirrjes së kuvendit në rast të skadimit të mandatit, zgjedhja dhe tërheqja e likuidatorit të Federatës, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të Federatës dhe format organizative, ndërprerja e ekzistencës së Federatës, mbi pasurinë, mënyrën e marrjes dhe asgjësimit të pronës, për procedurën me pronën në rast të ndërprerjes së Federatës, për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe konflikteve të interesit brenda Federatës dhe çështje të tjera me rëndësi për Federatën.

I - DISPOZITAT THEMELORE

Neni 2

Federata Atletike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Federata) është e vetmja federatë kombëtare sportive që inkurajon, promovon dhe kujdeset për sportin e atletikës në Kosovë dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Neni 3

Federata u themelua në vitin 1991 dhe u pranua në Shoqatën Botërore të Atletikës – Atletika Botërore (World Athletics - WA) në vitin 2015.

Neni 4

Federata nuk lejon diskriminim racor, kombëtar, fetar dhe politik, si dhe cenimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Neni 5

Federata është asociacion i regjistruar në Regjistrin e OJQ-ve të Republikës së Kosovës pranë organit kompetent administrativ. Federata është person juridik jofitimprurës.

Neni 6

Federata e ka Statutin, i cili është akti i përgjithshëm themelor i Federatës. Statuti duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare të Kosovës, Ligjit për Sport, Ligjit për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, Statutin e Komitetit Olimpik të Kosovës dhe Kushtetutën e Atletikës Botërore.

Neni 7

Federata vepron në territorin e Republikës së Kosovës.

Selia e Federatës është në Prishtinë, dhe adresa e selisë së Federatës përcaktohet nga Bordi Ekzekutiv i Federatës me vendim të tij.

Neni 8

Veprimtaritë e Federatës janë publike. Publiciteti i aktiviteteve të Federatës realizohet përmes:

- raporteve me shkrim për punën e Federatës,
- mediave,
- në faqen e internetit të Federatës,
- ose në një mënyrë tjetër të përshtatshme.

Neni 9

Përveç emrit të plotë, Federata përdor edhe emrin e shkurtuar FAK. Përveç emrit në gjuhën shqipe, Federata mund të përdorë emrin edhe në gjuhën angleze: Kosovo Athletic Federation.

Neni 10

Vula e Federatës është në formë të rrumbullakët, me diametër 38 mm, me tekstin rrethor: Federata Atletike e Kosovës dhe Kosovo Athletic Federation, ndërsa në mesin e vulës është simboli i vrapuesit. Në mes të vulës shkruhet me shkronja të mëdha: FAK.

Vula e protokollit e Federatës është në formë katrore, me përmasa 65 x 22 mm, në të cilën shkruhet: Federata Atletike e Kosovës, vendi për nr. i protokollit dhe hapësira për datë.

Neni 11

Simboli i Federatës përbëhet nga një rreth i formës ovale i cili simbolizon shtegun e atletikës dhe shkurtesës së federatës – FAK, me ngjyrë të kaltër të mbyllët dhe të bardhë, ndërsa shkronja A simbolizon vrapuesin. Tipografia thekson emrin e plotë të Federatës, në shqip dhe anglisht, një ngjyrë e kaltër e përbënë tërë simbolin.

Përdorimi i shenjës përcaktohet me vendim të veçantë të Bordit Ekzekutiv të Federatës.

Flamuri

Neni 12

Federata është themelues dhe anëtar i plotë i Komitetit Olimpik të Kosovës. Përfaqësuesit e Federatës në Asamblenë e Komitetit Olimpik të Kosovës i delegon Bordi i Federatës.

Neni 13

Federata është e asociuar në Federatën Evropiane të Atletikës (EA – European Athletics) dhe Shoqatës Botërore të Atletikës (WA - World Athletics).

II - QËLLIMET DHE AKTIVITETI

Neni 14

Qëllimet e Federatës janë:

- zhvillimi dhe promovimi i atletikës,
 - nxitja e kreativitetit të lartë sportiv dhe krijimi i kushteve për arritjen e rezultateve sportive,
 - promovimi i funksioneve edukative të sportit, aktivitetit sportiv të ndershëm, mirëkuptimit, tolerancës dhe përgjegjesisë nëpërmjet praktikimit të sportit,
 - përhapja e ideologjisë olimpike dhe forcimi i lëvizjes olimpike,
 - lufta kundër përdorimit të mjeteve stimulative të paligjshme në atletikë në përputhje me institucionet ndërkombëtare dhe kombëtare juridiksion i të cilave është.
 - angazhimi që të veprojnë ndaj detyrimeve dhe përgjegjësive që përcaktohen me Ligjin për Sport, Ligjin nr. 05/1-075 për Parandalimin dhe sanksionimi e Dhunës dhe Dukurive Negative në ngjarjet sportive dhe të gjithë legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë.
- Federata operon në fushën e sportit në përputhje me qëllimet e saj.

Neni 15

Aktivitetet e Federatës në përmbushjen e qëllimeve janë:

- nxit, promovon dhe zhvillon atletikën,
 - koordinon veprimtaritë e Anëtarëve,
 - përcakton dhe zbaton sistemin e garave,
 - ndihmon në vendosjen dhe zgjidhjen e çështjeve aktuale të statusit të anëtarëve të Federatës,
 - rregullon çështjet që kanë të bëjnë me regjistrimin e atletëve, statusin e atletëve dhe punonjësve të tjerë sportivë në atletikë, si dhe përgjegjësinë disiplinore të atletëve dhe punonjësve të sportit,
 - kujdeset për përmirësimin e punës profesionale dhe aftësimin e punonjësve profesionistë, si dhe për përmirësimin e arritjeve në atletikë,
 - kujdeset për atletët më të mirë,
 - mbikëqyr punën në atletikë,
 - kujdeset për ekipin e atletikës,
 - përfaqëson atletikën kosovare në Atletikën Botërore (WA), Atletikën Evropiane (EA) dhe Komitetin Olimpik të Kosovës,
 - përcakton kushtet materiale, personelin dhe kushtet e tjera që duhet të plotësojë një klub sportiv ose shoqatë sportive për të kryer veprimtari sportive në atletikë,
 - zbaton programin kombëtar të sportit nga institucionet gjegjëse,
 - miraton akte për statusin e atletëve profesionistë dhe veçanërisht për kushtet e pjesëmarrjes së tyre në garat sportive,
 - miraton akte për të drejtat e sportistëve të huaj për të performuar për klubet kosovare,
 - miraton akte për të drejtat dhe detyrimet e trajnerëve dhe personave që kryejnë punë profesionale në sport, si dhe aktet për të drejtat dhe detyrimet e zyrtarëve të garave dhe profesionistëve shëndetësorë, nëse këto çështje nuk rregullohen nga shoqatat profesionale të këtyre personave,
 - kryen edhe punë të tjera që janë të nevojshme për kryerjen e veprimtarive të Federatës,
- Federata ushtron veprimtarinë ekonomike të reklamimit dhe promovimit.

Neni 16

Qëllimet dhe aktivitetet e renditura në nenet 14 dhe 15 të këtij Statuti të Federatës realizohen me veprim të drejtpërdrejtë dhe të përbashkët të anëtarëve të asociuar, institucioneve sportive vendore dhe ndërkombëtare.

Neni 17

Për të arritur qëllimet dhe aktivitetet e parashtruara, Federata bashkëpunon me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komitetin Olimpik të Kosovës, Atletikën Botërore, Atletikën Evropiane, si dhe organet dhe organizatat tjera që janë në interes të zhvillimit të sportit të atletikës.

Neni 18

Federata nuk mund të kryejë veprimtaritë e saj me qëllim të përfitimit. Nëse Federata ka një fitim në kryerjen e veprimtarive të saj, ai duhet të përdoret ekskluzivisht për kryerjen dhe përmirësimin e veprimtarive të Federatës, të cilat realizojnë objektivat e Federatës të përcaktuara me këtë Statut.

III - ANËTARËSIA

Neni 19

Anëtarë të Federatës mund të jenë klubet sportive atletike, shoqëritë aksionare të sporteve atletike, institucionet e regjistruara për veprimtari atletike dhe shoqata të tjera, veprimtaria e të cilave është me rëndësi dhe interes për atletikën.

Neni 20

Personat juridik nga neni 19 i këtij Statuti, për t'u anëtarësuar në Federatë, duhet të plotësojnë normat dhe kriteret nga rregullorja për regjistrim të Anëtarit, në mesin e të cilave duhet paraqitur:

1. Kërkesën për anëtarësim në Federatë sipas formularit (FAK),
2. Certifikatën e regjistrimit në Ministrinë e shërbimeve publike,
3. Certifikatën e numrit fiskal (nëse nuk është e shënuar në certifikatën e OJQ-së),
4. Konfirmim të personit të autorizuar,
5. Llogari bankare aktive,
6. Vërtetimi për shlyerjen e obligimeve në ATK
7. Vendim për regjistrim në Komunën përkatëse
8. Statutin,
9. Rregulloren e kuvendit,
10. Rregulloren për punën e bordit,
11. Rregulloren e këshillit mbikëqyrës,
12. Procesverbalin nga mbledhja themeluese apo konstituive e Kuvendit të klubit,
13. Regjistri i të gjithë anëtarëve të Bordit, si dhe të gjithë zyrtarëve tjerë,
14. Dëshmi për trajner të licencuar nga FAK-u, apo institucionet varëse të atletikës,
15. Logon dhe ngjyrat zyrtare,
16. Të dhënat bazë për organizimin dhe veprimtaritë.

Sekretariati i Përgjithshëm verifikon dhe përgatitë dosjen e klubit që aplikon për anëtarësim.

Neni 21

Komisioni për Regjistrim të Anëtarit vlerëson plotësimin e normave dhe kritereve bazuar në rregulloren e Regjistrimit të Anëtarit dhe i propozon Bordit aprovimin për anëtarësim të Anëtarit.

Vendimin e përkohshëm për anëtarësimin e një Anëtarit të ri e merr Bordi Ekzekutiv i Federatës me shumicë të votave të gjithë anëtarëve.

Vendimin e përkohshëm për përfundim të anëtarësisë e merr Bordi Ekzekutiv i Federatës me shumicë të votave të gjithë anëtarëve.

Vendimin përfundimtar për anëtarësimin e një anëtarit të ri e merr Kuvendi i Federatës me shumicë të votave të gjithë delegatëve me të drejtë vote.

Vendimin përfundimtar për përfundim të anëtarësisë e merr Kuvendi i Federatës me shumicë të votave të gjithë delegatëve me të drejtë vote.

Neni 22

Anëtarët e Federatës kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen.

Anëtarët kanë të drejtë dhe detyrim të veprojnë në punën e Federatës dhe të propozojnë masa e aktivitete për realizimin më të suksesshëm të qëllimeve dhe detyrave të Federatës.

Anëtarët kanë për obligim që të respektojnë të gjitha propozicionet, rregullat dhe legjislacionin në fuqi të Federatës dhe institucioneve varëse të saj.

Anëtarët duhet të zbatojnë vendimet e Federatës dhe janë përgjegjës për zbatimin e tyre. Statutet e klubeve atletike, anëtarë të Federatës, duhet të përcaktojnë që ata të kryejnë veprimtarinë sportive dhe pjesëmarrjes në gara sportive.

Neni 23

Anëtarët e organit dhe personat e autorizuar për përfaqësimin e anëtarëve të Federatës nuk mund të jenë persona të cilët janë të penguar ta bëjnë këtë në bazë të dispozitave të Ligjit për Sport dhe legjislacionit të fuqi.

Neni 24

Statuti dhe aktet tjera të përgjithshme të anëtarëve duhet të jenë në përputhje me këtë Statut, legjislacionin në fuqi të Kosovës dhe aktet e tjera të përgjithshme të Federatës.

Neni 25 - Përfundimi i anëtarësisë

Anëtarësimi në Federatë përfundon:

- nëse anëtarit nuk mund të përmbushë normat dhe kriteret e përshkruara në rregulloren e regjistrimit të Anëtarit.
- me fshirje nga regjistri i OJQ-ve,
- nëse konstatohet se anëtarit ka pushuar së vepruari ose nëse nuk ka mbajtur asamble për të paktën dy vjet;
- nëse numri i atletëve të klubit gjatë vitit zvogëlohet nën numrin e përcaktuar për regjistrimin e anëtarit,
- mos shlyerja e obligimeve financiarë ndaj FAK-ut për dy vite me radhë.
- nëse një anëtar dëmton përparimin e Federatës me veprimet e tij ose nuk arrin qëllimet dhe detyrat për të cilat është themeluar,
- me kërkesën e anëtarit me shpjegim.

Kur një anëtar në veprimet e tij dëmton mbarëvajtjen e Federatës ose nuk arrin qëllime dhe detyra të caktuara për të cilat është themeluar, Zyra e FAK-ut do ta paralajmërojë

Komisionin për regjistrim të Anëtarëve me shkrim për mangësitë në punën e tij i cili do ta thërrasë Anëtarin të bëjë korrigjime. Nëse një anëtar vazhdon të veprojë në kundërshtim me dispozitat e Statutit të tij dhe të këtij Statuti edhe pasi të jetë paralajmëruar nga Komisioni për regjistrim të Anëtarëve, Bordi Ekzekutiv merr vendim që ti propozon Kuvendit që të marrë vendim për përjashtimin – suspendimin e tij nga anëtarësimi në Federatë.

Kundër propozimit të Bordit Ekzekutiv me të cilin një anëtar përjashtohet nga anëtarësimi në Federatë, anëtari mund të paraqesë ankesë brenda 15 ditëve nga marrja e dokumentit për përjashtim nga Bordit Ekzekutiv.

Ankesa vendoset nga Kuvendi i Federatës në seancën e parë të rregullt pasuese, i cili mund ta refuzojë ankesën dhe të konfirmojë vendimin e Bordit Ekzekutiv ose mund ta pranojë ankesën dhe të anulojë vendimin për përjashtimin nga anëtarësia.

Neni 26

Regjistri i anëtarëve mbahet në zyrën e FAK-ut në formë elektronike dhe fizike, i cili domosdoshmërisht përmban të dhëna për emrin e anëtarit, Bordin, personat e autorizuar për të përfaqësuar anëtarin, datën e anëtarësimit në Federatë dhe datën e përfundimit të anëtarësimit nëse kjo ndodhë.

IV - ORGANIZIMI

Kuvendi

Neni 27

Kuvendi i Federatës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi) është organi më i lartë që menaxhon punët e Federatës. Kuvendi mbledhet të paktën një herë në vit. Kuvendi zgjedhor mbahet çdo katër vjet.

Kryetari i Federatës thërret dhe kryeson seancat e Kuvendit në bazë të dispozitave të Statutit.

Ftesa për mbledhjen e rregullt me vendin dhe orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, si dhe materialet e nevojshme, anëtarëve të kuvendit u dërgohen me postë elektronike ose të rregullt, së paku 7 ditë para mbajtjes së kuvendit. Me publikimin e ftesës dhe materialeve në faqen zyrtare të FAK-ut, anëtarët konsiderohen se kanë marrë ftesën dhe materiale.

Kuvendi i Jashtëzakonshëm duhet të thirret nga Kryetari i Federatës:

- kur gjykon se është e nevojshme të mbledhet Kuvendi,
- me kërkesë shumicës së delegatëve me të drejtë vote,
- me kërkesë të shumicës së anëtarëve të Bordit Ekzekutiv,

Seanca e jashtëzakonshme duhet të thirret nga kryetari i Federatës në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës për thirrjen e saj, me faktin se propozuesi është i detyruar të paraqesë sqarim me shkrim dhe të propozojë rendin e ditës. Nëse Kryetari nuk e thërret Kuvendin brenda afatit të caktuar, seancën e Kuvendit mund ta thërrasë propozuesi sipas rendit të ditës së propozuar përmes zyrës së FAK-ut.

Neni 28

Të gjithë anëtarët kanë të drejtën të që së paku të përfaqësohen me nga një delegat në Kuvend. Bazë për përcaktimin e numrit dhe e drejta e votës në Kuvend është Rregullorja për përcaktimin e numrit të votave në Kuvendin e Federatës.

Delegatët e Kuvendit janë përfaqësues të anëtarëve (klubeve) që plotësojnë normat dhe kriteret nga rregullorja e regjistrimit të Anëtarit.

Mandati i delegatit të Anëtarit në Kuvend përcaktohet nga Anëtari dhe duhet të vërtetohet në zyrën e FAK-ut çdo vit. Anëtari i Federatës mund të emërojë zëvendësues.

Neni 29

Mandati i delegatit në Kuvend mund të përfundojë edhe para përfundimit të mandatit për të cilin është zgjedhur, në rastet kur:

- ndryshon ose humbë shtetësinë
 - fajësimi ose shkarkim,
 - paraqitjen e dorëheqjes,
 - ndodhin rrethana, për shkak të të cilave ai nuk do të mund të kryej më detyrën,
 - për shkak të shkeljeve disiplinore ose Kodit Etik,
- Vendimi për tërheqjen e një përfaqësuesi në Kuvend merret nga organi që e ka zgjedhur atë.

Neni 30

Përfaqësues në Kuvend mund të jetë personi i/e cili:

- është shtetas i Republikës së Kosovës
- ka mbushur moshën 18 vjeç dhe është i aftë të punoj,
- është apo ka qenë atlet apo sportist i dalluar,
- në tre vitet e fundit nuk është dënuar ligjërisht për vepra penale të përcaktuara në Kapitullin XXXIII të Kodit Penal të cilat ndërlidhen me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare.
- nuk ka qenë bartës i funksioneve në organet drejtuese anëtarë të subjekteve të cilat merren me organizimin e basteve sportive së paku tre vitet e fundit.

Neni 31

Kuvendi kryen këto detyra:

- miraton Statutin, rregulloren punës së Kuvendit, rregulloren e Këshillit Mbikëqyrës dhe rregulloren e punës së Bordit,
- përcakton politikën dhe programet afatgjata të Federatës,
- përcakton sistemin e garave në atletikë,
- miraton planin e punës dhe planin financiar për vitin e ardhshëm kalendarik dhe raportin e punës për vitin e kaluar kalendarik dhe miraton llogarinë përfundimtare,
- vendos për anëtarësim apo heqje të anëtarësisë së anëtarëve,
- shqyrton çështjet aktuale në lidhje me punën e Federatës, merr qëndrime dhe miraton akte të përgjithshme dhe individuale në juridiksionin e tij,
- shqyrton dhe vendos për pranimin e raporteve të punës nga fusha e kompetencës së tij,
- zgjedh dhe shkarkon Kryetarin, nënkryetarët, Bordin Ekzekutiv dhe Këshillin Mbikëqyrës,
- vendos për shuarjen e Federatës.

Neni 32

Puna e kuvendit është e vlefshme nëse në seancë janë prezent shumica e delegatëve me të drejtë vote.

Në rast se në seancën e Kuvendit nuk është i pranishëm numri i delegatëve që përbëjnë shumicën e votave, seanca shtyhet dhe numri i të pranishmëve që përbëjnë kuorumin përcaktohet më poshtë.

Kuvendi merr vendime me shumicë të votave (për) të delegatëve të pranishëm në seancë.

Për pranimin dhe përfundimin e anëtarësisë së Anëtarit duhet të votojnë (për), shumica e delegatëve me të drejtë vote.

Për ndryshimet statutore, rregulloren e punës së kuvendit, votëbesimin e kryetarit janë të nevojshme 2/3 e numrit të votave (për), të delegatëve me të drejtë vote.

Neni 33

Rregullorja e punës së Kuvendit rregullon mënyrën e veprimit, të drejtat dhe detyrimet, si dhe kushtet e punës së përfaqësuesve në Kuvend, si dhe çështje të tjera të rëndësishme për punën e suksesshme të tij.

Bordi Ekzekutiv

Neni 34

Kryesia FAK-ut përbëhet nga 11 anëtarë (7 anëtarë të zgjedhur nga kuvendi ku dy duhet të jenë të gjinisë femërore).

Me propozim e anëtarëve, Kuvendi zgjedh 7 (shtatë) anëtarë nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Federatës.

Kryetari i Federatës ka të drejtë të propozojë deri në tre anëtarë të rinj në Bordit Ekzekutiv, mandati i të cilëve zgjat deri në përfundimin e mandatit të anëtarëve të tjerë të Bordit Ekzekutiv. Mandati i anëtarëve të Bordit Ekzekutiv zgjat katër vjet.

Në rast se një anëtar i Bordit Ekzekutiv pengohet dhe nuk ka mundësi të kryejë detyrat e tij, apo mungon tri herë radhazi pa arsye në mbledhje të Bordit Ekzekutiv, Kryetari në mbledhjen e radhës së Bordit duhet të propozoj zgjedhjen e një anëtar të ri të Bordit Ekzekutiv në bazë të numrit të votave të grumbulluara nga Kuvendin zgjedhor paraprak.

Neni 35

Bordi ekzekutiv është kompetent për:

- zbaton politikën e vendosur për zhvillimin e atletikës në Republikën e Kosovës të vendosur nga Kuvendi i Federatës,
- përcakton propozimin e Statutit të Federatës, si dhe ndryshimet e tij, si dhe aktet dhe vendimet e tjera të përgjithshme që miratohen ose shqyrtohen nga Kuvendi i Federatës;
- përcakton organizimin dhe mënyrën e kryerjes së punëve profesionale, administrative-teknike dhe ndihmëse për nevojat e Federatës;
- përcakton kushtet dhe rregullat e organizimit të garave,
- i propozon Kuvendit të Federatës miratimin e programit vjetor, planin financiar dhe pranimin e Llogarisë Përfundimtare të Federatës,
- miraton një plan të përkohshëm financiar në pritje të miratimit të planit financiar në Kuvend,
- koordinon planin financiar të Federatës gjatë vitit në përputhje me programin dhe fondet e përcaktuara dhe në kuadër të planit financiar vendos për orarin dhe dinamikën e përdorimit të fondeve.
- zgjedhë auditorin e jashtëm për të kryer auditimin në Federatë për çdo vit,
- menaxhon pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të Federatës,
- zbaton dhe siguron zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Federatës,
- miraton rregullore dhe akte të përgjithshme sipas nevojës,
- propozon Kuvendit për pranimin e anëtarëve në Federatë dhe përjashtimin e tyre,
- organizon punën dhe veprimtarinë e Federatës ndërmjet seancave të Kuvendit,

- themelon dhe shpërndan të gjitha komisionet dhe këshillat (organet ndihmëse) dhe emëron kryetarin dhe anëtarët e komisionet dhe këshillave të Federatës;
- zgjidh të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut dhe për këtë i raporton Kuvendit të Federatës në seancën e ardhshëm,
- zgjedh sekretarit e përgjithshëm të Federatës me propozim të kryetarit, apo anëtarëve të Bordit,
- përcakton zyrtarin-ët e ekipit kombëtar në garat ndërkombëtare dhe sipas mundësisë konfirmon atletët e ekipit kombëtar të propozuar nga këshilli profesional apo selektorët (sipas kriterëve të rregullores së pjesëmarrjes në gara ndërkombëtare).
- emëron dhe shkarkon anëtarët e komisioneve dhe organeve të federatës në kompetencën e tij.

Bordi ekzekutiv mund të themelojë trupa punues të përhershëm dhe të përkohshëm. Bordi Ekzekutiv, duke vendosur për emërimin e trupave punues të përhershëm dhe të përkohshëm, përcakton përbërjen, fushëveprimin, përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre.

Neni 36

Bordi ekzekutiv funksionon në seanca. Seancat e Bordit Ekzekutiv mbahen sipas nevojës, të paktën një herë në dy muaj.

Seanca e Bordit Ekzekutiv mund të mbahet dhe vendimet mund të merren në mënyrë elektronike (platformat online, e-mail, faks).

Në raste urgjente, seanca e Bordit Ekzekutiv mund të mbahet edhe me telefon dhe aplikacione grupore.

Seancat e Bordit i thërret kryetari sipas nevojës, ndërsa rendin e ditës e harton në konsultim me Sekretarin e Përgjithshëm të FAK.

Në raste të jashtëzakonshme kryetari e ka obligim të thërras mbledhjen e Bordit me kërkesën e së paku ½ të anëtarëve të Bordit.

Neni 37

Bordi ekzekutiv në mënyrë të vlefshme vendos nëse në seancë janë të pranishëm më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Bordi ekzekutiv merr vendime me shumicë votash të numrit të anëtarëve të pranishëm.

Neni 38

Bordi Ekzekutiv për punën e tij i përgjigjet Kuvendit.

Neni 39

Bordi me shumicë të thjeshtë të votave emëron dhe shkarkon anëtarët e komisioneve dhe organeve tjera, si më poshtë:

- Këshilli Profesional për zhvillimin e atletikës prej 5 anëtarëve,
- Komisioni Disiplinor dhe i etikës prej 3 anëtarëve, një nga anëtarët duhet të jetë juristë me profesion
- Komisioni për Ankesa prej 3 anëtarëve një nga anëtarët duhet të jetë juristë me profesion
- Komisioni Marketing dhe Media prej 3 anëtarëve,
- Komisioni i Garave prej 3 anëtarëve,
- Komisioni Shëndetësor prej 3 anëtarëve,
- Komisioni i Regjistrimit të Anëtarit prej 3 anëtarëve,
- Komisioni Statutor prej 3 anëtarëve,

- Komisioni i Atletëve prej 3 anëtarëve,
- Komisioni i Femrave prej 3 anëtarëve,
- Komisioni i Veteranëve prej 3 anëtarëve.

Bordi me shumicë të votave emëron dhe shkarkon edhe komisione tjera punese, sipas nevojës.

Me vendimin për themelimin e Komisionit dhe organeve të tjera punuese përcaktohen detyrat dhe mënyra e punës sipas rregulloreve përkatëse të aprovuara nga Bordi.

Përveç anëtarëve të Kuvendit dhe Bordit në përbërjen e komisioneve apo organeve tjera punuese mund të emërohen edhe punëtor të tjerë të atletikës, me kusht që një person mund të jetë anëtar më së shumti i një komisioni apo organi tjetër.

Punën e komisioneve dhe organeve tjera punuese e koordinon sekretari i përgjithshëm i FAK-ut, nëse në vendimin për krijimin e organit nuk është thënë ndryshe.

Këshilli Mbikëqyrës

Neni 40

Mbikëqyrjen e punës dhe veprimtarisë së Federatës e kryen Këshilli Mbikëqyrës. Këshilli mbikëqyrës ka një kryetar dhe dy anëtarë.

Neni 41

Kryetari, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen nga Kuvendi sipas procedurës së parashikuar për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen nga jashtë përbërjes së organeve të Federatës.

Mandati i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës zgjat katër vjet.

Neni 42

Këshilli Mbikëqyrës mbikëqyr dhe kontrollon zbatimin e ligjshmërisë në punën dhe veprimet materiale e financiare të Federatës.

Neni 43

Këshilli Mbikëqyrës funksionon në seanca të mbajtura të paktën një herë në vit. Këshilli Mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm nëse janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

Këshilli Mbikëqyrës merr vendime me shumicë votash.

Këshilli Mbikëqyrës i raporton Kuvendit.

Kryetari dhe nënkryetarët

Neni 44

Federata ka një kryetar dhe dy nënkryetarë të cilët janë gjithashtu anëtarë të Bordit Ekzekutiv.

Kryetari zgjidhet nga Kuvendi me votim të drejtpërdrejtë. Nënkyetarët zgjidhen me propozimin e Kryetari dhe aprovohen nga Bordi Ekzekutiv.

Kandidat për kryetar mund të propozohet nga çdo anëtar i Federatës me të drejtë vote, së paku 15 ditë para Kuvendit. Kandidati për kryetar duhet të plotësoj kushtet e përcaktuara me ligj, statut dhe rregullore të Federatës dhe të paraqet një CV, planin dhe programin e atletikës për 4 vitet e ardhshme.

Mandati i kryetarit zgjat katër vjet dhe është kryetar i Federatës, Kuvendit dhe Bordit Ekzekutiv.

Kryetari i Federatës është anëtar i Kuvendit sipas funksionit dhe ka të drejtë vote.

Neni 45

Kryetari i Federatës:

- udhëheqë dhe përfaqëson Federatën,
- thërret dhe kryeson seancat e Kuvendit dhe të Bordit Ekzekutiv,
- nënshkruan aktet e përgjithshme të miratuara nga Kuvendi ose Bordi Ekzekutiv,
- kujdeset për zbatimin e qëndrimeve, vendimeve dhe konkluzioneve të Kuvendit dhe të Bordit Ekzekutiv,
- kryen punët e përcaktuara me këtë Statut dhe akte të tjera të përgjithshme të Federatës;
- kryen edhe detyra të tjera.

Neni 46

Kryetari ose nënkryetarët për punën e tyre i përgjigjen Kuvendit.

Neni 47

Federata përfaqësohet nga Kryetari, dhe në mungesë ose pamundësi të tij, nga njëri prej nënkryetarëve të autorizuar nga Kryetari.

V - ZYRA E FEDERATËS

Neni 48

Zyra e Federatës shërben për kryerjen e detyrave profesionale, administrative-teknike dhe ndihmëse të Federatës.

Sekretari i përgjithshëm

Neni 49

Për të kryer punë profesionale, administrative dhe teknike Bordi zgjedhë sekretarin e përgjithshëm bazuar në punën dhe përvojën e mëhershme në sportin e atletikës.

Kryetari i propozon Bordit kandidatin për sekretar të Përgjithshëm, ndërsa Bordi e aprovon me shumicë votash zgjedhjen e tij.

Sekretari i përgjithshëm zgjidhet për mandat katër (4) vjeçar. Sekretari i përgjithshëm mund të rizgjidhet në këtë pozitë.

Për punën e tij, Sekretari i Përgjithshëm i përgjigjet kryetarit dhe në mënyrë periodike tre mujore i raporton Bordit.

Neni 50

Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Atletike duhet të jetë në marrëdhënie pune të rregullt në FAK. Nëse rrethanat e kërkojnë ndryshe, atëherë sekretari i përgjithshëm në negociim me kryetarin mund të vendosin për forma të tjera të angazhimit. Vendimin për këtë, si dhe çështje të tjera që lidhen me sekretarin e përgjithshëm i miraton Bordi. Për marrëdhënien e punës ndërmjet sekretarit të përgjithshëm dhe FAK, duhet të vendoset konform ligjeve në fuqi të republikës së Kosovës.

Nëse shihet e nevojshme, FAK-u mund të rekrutoj staf tjetër për të kryer punë teknike-profesionale. Sekretari nxjerr vendim për rekrutim të cilin e aprovon Bordi.

Neni 51

Sekretari i Përgjithshëm i FAK-ut është përgjegjës për:

- Përfaqësimin e FAK-ut në kuadër të kompetencave të tij dhe në harmoni me kryetarin dhe dokumentet tjera planifikuese, ligjore dhe strategjike të FAK,
- Përgatitjen dhe zbatimin e planit financiar në përputhje me këtë Statut,
- Menaxhon financat e federatës,
- Kryen veprimtari në përputhje me vendimet përkatëse, konkluzionet dhe masat e Kuvendit dhe të Bordit,
- Përgatit dhe merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit, Bordit dhe takimet tjera zyrtare sipas kompetencave të FAK-ut,
- Është përgjegjës në menaxhimin dhe administrimin e të gjitha punëve të FAK-ut,
- Është përgjegjës për shfrytëzimin ligjor të vulave të Federatës Atletike dhe ruajtjen e tyre,
- Është përgjegjës për ruajtjen e pronës dhe ligjshmërinë e punës së Federatës Atletike,
- Kryen detyra të tjera të cilat ia ka besuar Bordi i Federatës,
- I përgjigjet kryetarit në baza të rregullta dhe kryesisë në periudha 3 mujore apo edhe më shpesh nëse një gjë të tillë e kërkon Bordi.
- Zbatimin e detyrave nga paragrafi 1. i kryen në harmoni me kryetarin e FAK.

VI - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE KONFLIKTET E INTERESAVE

Neni 52

Zgjedhja e mosmarrëveshjeve dhe e konfliktit të interesave ndërmjet anëtarëve të Federatës, debitorëve të Federatës, trajnerëve dhe atletëve rregullohet me rregullore disiplinore, Kodi Etik të Federatës, Kodi Etik të Zyrtarëve të Garave dhe Kodi Etik të Atletikës Botërore.

Komisioni Disiplinor është organ i pavarur i Federatës që zgjidh mosmarrëveshjet dhe konfliktet e interesit.

Komisioni Disiplinor përbëhet nga 3 anëtarë (një prej të cilëve me profesion duhet të jenë jurist) dhe vendimet e tyre merren në përbërje të plotë me shumicë votash. Anëtarët e komisionit disiplinor zgjidhen për 4 vjet.

Anëtari i komisionit disiplinor nuk mund të jetë anëtar i asnjë organi tjetër të Federatës.

Kundër vendimeve të Komisionit Disiplinor në procedurë disiplinore, lejohet ankimi në Komisionin për Ankesa. Nëse vendimet e Komisionit Disiplinor dhe Komisionit për Ankesa janë në kundërtënie atëherë Gjykata e Arbitrazhit Sportiv të Komitetit Olimpik të Kosovës (GJAS) merr vendimin përfundimtar.

Vendimi i Komisionit Disiplinor i cili zgjidh mosmarrëveshjet dhe konfliktet e interesit ndërmjet anëtarëve të FAK-ut është përfundimtar.

Puna e komisionit disiplinor rregullohet me Rregulloren Disiplinore. Komisioni në bazë të rregullores disiplinore duhet të zgjidh çështjet disiplinore që dalin nga Kodi Etik i Federatës, Kodi Etik i Zyrtarëve të Garave dhe Kodi Etik i Atletikës Botërore.

Neni 53 - Komisioni për Ankesa

Komisioni për ankesa në përbërje prej tre anëtarëve propozohet dhe zgjidhet nga Bordi. Një nga anëtarët duhet të jenë jurist.

Komisioni për ankesa është përgjegjës për trajtimin e ankesave kundër vendimeve të Komisionit Disiplinor të cilat nuk konsiderohen si përfundimtare nga rregullorja përkatëse e FAK-ut

Vendimet merren vetëm kur komisioni është në përbërje të plotë.

Varësisht prej çështjes së ankesës komisioni punon me rregulloret përkatëse duke respektuar rregulloren e punës së Komisionit për Ankesa.

Vendimet e dhëna nga Komisioni i ankesave për çështje disiplinore mund t'i drejtohen vetëm gjykatës së Arbitrazhit Sportiv të Komitetit Olimpik të Kosovës (GJAS) dhe pastaj edhe CAS (në Llozanë).

VII – LEGJISLACIONI

Neni 54 - Komisioni Statutor

Komisioni statutor në përbërje prej tre anëtarëve propozohet dhe zgjidhet nga Bordi.

Një nga anëtarët duhet të jenë jurist me profesion.

Të gjitha propozimet për ndryshimet statutorë për komisionin statutor mund të vijnë nga Bordi ekzekutiv, Kuvendi, Komisionet dhe organet relevante të sportit në Kosovë dhe jashtë Kosovës.

Komisioni statutor më tej i propozon Bordit ndryshimet statutorë të federatës, rregulloren e punës së Kuvendit.

VIII - PËRFAQËSIMI SHTETËROR

Neni 55

Për të promovuar dhe arritur performancë më të lartë në atletikë, Federata organizon ekipe kombëtare.

Atletët janë të obliguar që në përzgjedhjet e Federatës të garojnë në kampionatet kombëtare dhe si pjesë e ekipit kombëtar.

Neni 56

Rregullorja për ekipet kombëtare rregullon mënyrën e funksionimit të kombëtares, fushëveprimin, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që mbulojnë atletët, trajnerët dhe të gjithë anëtarët e ekipit kombëtar.

IX - KRYERJA E PUNËVE PROFESIONALE NË ATLETIKË

Neni 57

Kushtet për kryerjen e punëve profesionale në atletikë mund të përcaktohen edhe me urdhëresën për marrjen dhe përtëritjen e licencave për kryerjen e punëve profesionale në atletikë, e cila bazohet në dispozitat e Ligjit për sport.

X - ORGANIZIMI I GARAVE NDËRKOMBËTARE NË ATLETIKE

Neni 58

Propozimin për mbajtjen e garave ndërkombëtare në atletikë e jep Federata Atletike e Kosovës me pëlqimin e organeve kompetente shtetërore – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

XI - BIZNESI MATERIAL DHE FINANCIAR

Neni 59

Federata gjeneron të ardhura nëpërmjet aktiviteteve të veta, nga fondet e siguruara nga Republika e Kosovës në Buxhetin e Shtetit dhe që i alokohen Federatës, duke paguar anëtarësi, kontribute vullnetare, dhurata, sponsorim dhe burime të tjera në përputhje me ligjin.

Neni 60

Fondet buxhetore të FAK-ut janë fonde të dedikuara rreptësishtë dhe mund të përdoren vetëm si të tilla.

Neni 61

Fondet të cilat Federata i realizon përmes aktiviteteve të veta janë në dispozicion të Federatës dhe vendimin për përdorimin e tyre e merr Bordi Ekzekutiv.

Neni 62

Shpërndarja e fondeve totale kryhet nga plani financiar i Federatës në përputhje me programin vjetor dhe aktiviteteve që paraqiten.

Neni 63

Veprimet materiale dhe financiare të Federatës kryhen në përputhje me rregulloret ligjore. Organizimin dhe menaxhimin e afarizmit material dhe financiar Federata mund t'ia besojë një shërbimi, organizate ose individit tjetër profesional dhe kryerja e menaxhimit mund të sigurohet me lidhjen e kontratës për kryerjen e asaj pune mes palëve.

Neni 64

Federata mund të fitojë pasuri të luajtmshme dhe të paluajtmshme. Kuvendi vendos për blerjen, shitjen, kalimin te një person tjetër juridik ose dhënien me qira të sendeve të paluajtmshme.

XII - MIRËNJOHJET DHE ÇMIMET

Neni 65

Çdo vit federata jep mirënjohje, çmime për kontribute të veçanta në zhvillimin e atletikës.

Neni 66

Rregullorja e laureatëve rregullon procedurën, kushtet dhe mënyrën e emërimit dhe vlerësimit të laureatëve.

XIII - SHUARJA E FEDERATËS

Neni 67

Federata pushon së funksionuari kur këtë e vendos Kuvendi me 2/3 e të gjithë delegatëve me të drejtë vote, ose në raste të tjera të parashikuara me ligjet në fuqi.

Neni 68

Në rast të shuarjes së Federatës, prona e Federatës do të kalojë në pronësi të shoqatës sportive të ngjashme, e cila do të vazhdojë aktivitetet e saj me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të atletikës në territorin e Republikës së Kosovës.

Nëse një shoqatë e tillë sportive nuk ekziston, asetet e Federatës do të merren nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

XIV - ZGJEDHJA DHE REVOKIMI I LIKUIDATORIT

Neni 69

Likuiduesi i shoqatës zgjidhet nga Kuvendi me propozimin e Bordit Ekzekutiv. Likuidues mund të jetë edhe një person juridik që nuk është anëtar i Federatës, dhe duhet të ketë ekspertizën e duhur në mënyrë që të mund të kujdeset për shpërndarjen e aseteve të FAK-ut.

Likuiduesi ka të drejtë të rimbursohet për punën e tij nga fondet e FAK-ut në masën e përcaktuar nga Bordi Ekzekutiv.

Likuiduesi e kryen likuidimin e Federatës në pajtim me dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

XIV - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 70

Ndryshimet në Statut përcaktohen në mënyrën dhe procedurën e parashikuar si në miratimin e tij.

Neni 71

Interpretimi i Statutit jepet në Kuvend.

Neni 72

Të gjitha aktet e përgjithshme të Federatës do të harmonizohen me dispozitat e këtij Statuti brenda 180 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 73

Anëtarët e Federatës janë të detyruar të harmonizojnë aktet e tyre të përgjithshme me këtë Statut brenda 180 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 74

Ndryshimet në Statut hyjnë në fuqi dhe zbatohen nga data e miratimit nga kuvendi.

Neni 75

Me hyrjen në fuqi të këtij statuti përfundon zbatimi i statutit të Federatë Atletike të Kosovës i vitit 2019 dhe akteve tjera në fuqi.

Neni 76

Ky statut hyn në fuqi shtatë ditë pas datës së publikimit në faqen zyrtare të Federatës.

Prishtinë, më
30.11.2022

Kryetari i FAK-ut
Halil Sylejmani

